

Erozioni i tokës përfaqeson një nga dukuritë shkatrimtare të relievit tokësor, si nëpërmjet gërryerjes sipërfaqesore dhe asaj në thellësi. Veprimtaria relativisht e dukshme e erozionit ujon që vërehet kudo është e favorizuar nga mjaft faktorë si relievi, përbërja gjeologjike, pjerrësia, veshja me bimësi, toka, klima etj. Në varësi nga këto kushte, rezulton një rregullshmëri pak a shumë e dukshme e gërryerjes në krasten e prrenjasit po ashtu dhe në lagjet periferike.

Për të gjitha rastet është e domosdoshme të kryhen punime të karakterit biologjik ashtu dhe hidroteknik. Roli vendimtar për sistemimin e prrenjve malor i takon bimësisë, sidomos asaj pyjore. Por funksionin e saj mbrojtës, bimësia nuk e luan menjëherë pas instalimit të saj, kështu që paralelisht me punimet e pyllzimit duhet të kryhen dhe punime të ndryshimeve hidroteknike përmbajtjen e materialeve të ngurta, forcimin e shtratit dhe drejtimin e rrjedhjes ujore.

KUSHTET KLIMATIKE

Të gjithë elementët kryesore klimatik, sidomos reshjet edhe temperaturat ndikojnë jo vetëm në mënyrë të drejtpërdrejtë por edhe në mënyrë të tërthortë në lindjen dhe zhvillimin e erozionit të tokës, prandaj dhe studimi i tyre ka rëndësi të veçantë si për raste kur duam të projektojmë masa për luftimin e gërryerjeve ashtu edhe në zbatimin e punimeve agro-silvoteknike. Një vëmendje shumë e veçantë i është kushtuar jo vetëm sasisë së përgjithshme të reshjeve, e cila jep në përgjithësi idenë mbi lagështinë e një territori, por edhe shpërndarjen e tyre stinore e mujore. Theksojmë se ndikim të drejtpërdrejt në gërryerjen e tokës ka sidomos intensiteti i rënies së tyre, i cili ndikon jo vetëm në sasinë e përgjithshme të rrjedhjes por edhe në fuqinë gërryese të tyre.

TE DHENA PËR HARTIMIN E PROJEKTIT

Vendi i ndertimit -- Qyteti Prrenjas

Qellimi i ndertimit -- Permiresimi i infrastruktures të kanalizimeve të ujrave të larta Qyteti Prrenjas.

[Hartimi i projektit është mbështetur si më poshte:](#)

I- Gjendja aktuale e kanalit.

II--Detyra e projektimit dhene nga Bashkia Prrenjas.

III--Zhvillimi i projektit per :

PER PROJEKTIN: Rikonstruksion i kanalit te "Xhelos", faza e II dhe sistemim i ujërave te larta ne "Krastën e Prrenjasit", qyteti Prrenjas, Bashkia Prrenjas.

Kanali i xhelos "Faza e II" ose kanali nr 1 ne Qytetin Prrenjas ka nje shtrirje gjeografike jug -veri te qytetit Prrenjas dhe ka nje gjatesi pej 380 ml dhe sherben per mbledhjen ujrave te shiut .

Rikonstruksioni i fazes se dyte fillon nga rruga" Muhamet Kadia" dhe shtrihet ne veri te qytetit Prrenjas me L-380 ml.

Kanali eshte ndertuar ne vitin 2004 dhe ne keto vite kanali ka pesuar amortizime te dukshem si ne demtimin e shtresave e betonit te dyshemese te kanalit dhe te mureve anesore , te cilen ka veshtiresuar kalimin e ujrave per shkak te ketij demtimi, kjo ka ardhur si shkak i temperaturave teper te ulta ne stinen e dimrit, te cilat kane sjelle dhe demtimin e strukturave te betonit dhe te mbushjes me materiale inerte nga renia e shirave apo dhe te ujrave te tjera nga familjaret pasi kanali ne te dy anet e kanalit jane ndertuar banesa private te cilat shtojne sasine ujrave ne kanal, pasi ne keto vite qyteti Prrenjas ka rritje te popullsisë per shkak te migrimit te popullsisë nga zonat rurale ne drejtim te qytetit Prrenjas, ku popullësia sot ne qytet ka rreth 11000 banore .


Duke u nisur nga kerkesat e vazhdueshme dhe shqetesim te banoreve per te bere rikonstruksionin e kanalit, nga Bashkia Prrenjas, ky shqetesim eshte pare me perparesi dhe eshte vleresuar si emergjente rikonstruksioni i ketij kanali.

Drejtoria e Planifikimit, Zhvillimit të Territorit dhe Aplikimit të Projekteve ka bere matje direkt ne terren dhe eshte hartuar projekti per rehabilitimin e kanalit.

Ne projekt jane parashikuar keto punime qe do te kryen:

- Prishja e shtresave te betonit ne te gjithe gjatesine e kanalit prej 380 ml.
- Pastrimi i kanalit nga dherat dhe mbetjet urbane.
- Prerja e pemeve ne kanal dhe pas kanalit.
- Trasportimi i materialeve te te dherave dhe te betonit ne vendin e caktuar.

Pasi te jene perfunduar keto punime do te behet betonimi i kanalit sipas preventivit te hartuar dhe profileve ku marka e betonit do te jete C-25/30 per ti rezistuar temperaturave te ulta ne stinen e dimrit, pasi ne periudhen e dimrit temperaturat shkojne ne - disa grade nen zero te cilat krijojne erozion dhe demtim te argjaturave te kanaleve dhe te tokes.



QYTETI PRRNJAS KANALI NE ORTOFOTO

2. SISTEMIM I UJËRAVE TE LARTA NE KRASTEN E PRRNJASIT, QYTETI PRRNJAS, BASHKIA PRRNJAS.

Nga krasta e prrnjasisit ose kurora e gjelber gjate renies te shirave vershojne ujera me intensitet te larte te cilat bien ose vershojne ne qytetin Prrnjias ne pjesen veriore ku kane shkaterruar rruge dhe banesa duke sjelle materiale nga krasta ne te dy anet simetrike, nga ana perendimore dhe nga ana lindore .

Duke u nisur nga shqetesimet e vazhdueshme te banoreve te lagjeve, per sistemim te ketyre ujrave u pa e domosdoshme nga Bashkia dhe nen drejtimin e kryetarit te Bashkise te hartohet projekti i rehabilitimit ose te sistemimit te ketyre ujrave duke ndertuar ne te dy anet kanale betoni 2 dhe 3 te ujrave te larta, te cilat shkarkojne ne kanaline 1 ose kanalin " Xhelos" qe do te behet rikonstruksion njehereresh me dy te tjerat.

Ne detyren e projektimit eshte patur parasysh detajimi i te gjithë elementeve te rikonstruksionit te kanaleve, si shtrirja, pjerresia e rruges, perberja e shtresave ekzistuese, shtresat qe do te shtrohen si heqja ose skarifikimi i shtreses ekzistuese .

Vleresimet e fortesise te tabanit te kanalit bazohen ne njohjen e tipit te dheut dhe se si dheu reason ndryshimeve te permbajtjes te lageshtise ne kushte ambientale te vecanta kundret ngjeshjes.

Cilesia e materialeve te shtresave meret ne perputhje me specifikimet teknike .

Per llogaritjen sipas metodologjise duhet te kemi parasysh disa koncepte si kapaciteti struktural (numri struktural) qe shpreh fortesine e tabanit.

Shtresa e re si granil, e cila do te rulohet ose ngjeshet me makineri, vendosja e hekurit, 8 dhe 6 mm, menyra e vendosjes se hekurit lidhja e dy \emptyset -ve me njera tjetren .

Vendosja e shtreses te betonit mbi hekurin do te behet pasi hekuri te jete fiksuar mire dhe te jete i shtrire mire pa pengesa te tjera te copave te ngelura te hekurit me maje qe mund te dalin mbi beton .

3.PERZIERJA E BETONIT.

Perzierjet dhe llojet e ndryshme te betonit do te perfitohen ne perpjestim me rregullat qe pefitojne fortesine e kerkuar.

Permbajtja e ujit ne beton duhet te kontrollohet rigorozisht dhe te mbahet ne minimumin e kerkuar per te perfituar nje beton te pershtatshem e punimit qe do te kryhet.

Ne asnje rast nuk duhet qe raporti i ujit dhe çimentos te kaloje raportin uje/cimento 0.50%.

Shkalla e perzierjes te betonit percaktohet nga nje numer, i cili eshte fortesia 28 ditore, qe tregon se betoni e ka fituar fortesine kerkuar (ose koinsistencen).

4. Preventivi i plote i zbatimit te punimeve i vleresuar me çmimet e tregut sot, ku perfshihen edhe taksat ne fuqi dhe tvsh 20%.

5. Konkluzione

Nga verifikimet ne vend dhe nga llogaritjet konkludojme se eshte e domosdoshme rikonstruksioneve i kanalit te qytetit. Ne projekt eshte dhe mos cenimi i pronave private .

➤ Rekomandime

- Me pare te filloje ndertimi i i kantierit per grumbullimin e bazes materiale. Rekomandojme qe para se te filloje zbatimi i projektit te merret leja e ndertimit dhe leja tek pronaret e tokave .

- **Preventivi i vepres.**

Preventivi i punimeve bazuar Vendimit nr. 216, datë 13.4.2023, “Për krijimin dhe funksionimin e sistemit të integruar për informatizimin e manualit të çmimeve për zërat e punimeve në ndërtim”.

Preventivi i zbatimit te punimeve i vleresuar me cmimet e tregut sot dhe me struktura preventivi TVSH 20%.

Realizimi sipas projektit dhe ne afat i vepres ploteson me se miri nevojat per rehabilitimin e ketij kanali te banoreve te qytetit dhe realizimit te nje infrastrukture bashkohore.

RELATOI

VIKING ENGINEERING SHPK